



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2025

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit (KO), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

**Baza për Opinion të Kualifikuar**

- A1 Komuna nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive në PFV. Pasuritë në vlerë prej 2,130,174€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive, ndërsa vlera e pasurive ishte mbivlerësuar për gjithsej 109,475€, si rezultat i mosaplikimit të zhvlerësimit, aplikimit të gabuar të normës së zhvlerësimit dhe regjistrimit të dyfishtë të pasurive.
- A2 Regjistri i pasurive nuk ishte harmonizuar me të dhënat e regjistrit kadastral. Në regjistrin e pasurive figurojnë 135 parcela në vlerë prej 7,129,043€ të cilat nuk rezultojnë në emër të Komunës, ndërsa në regjistrin kadastral figurojnë 114 parcela dhe një objekt në pronësi të Komunës që nuk janë përfshirë në regjistrin e pasurive. Për më tepër, disa objekte nuk janë evidentuar në kadastrë, ndërsa 11 objekte/lokale vazhdojnë të figurojnë si pronë e Komunës, ndonëse nuk ekzistojnë më fizikisht.
- B1 Komuna nuk kishte bartur në regjistrin e pasurive projekte të përfunduara dhe të pranura teknikisht, të cilat vazhdonin të figuronin si investime në vijim. Vlera e projekteve/situacioneve të mbetura si investime në vijim ishte 1,291,484€, ndërsa zhvlerësimi i paaplikuar për to ishte 54,583€, duke ndikuar në mbivlerësimin e pasurive.
- B2 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,911,816€, nga kategori ekonomike jo adekuate.
- A3 Detyrimet kontingjente në PFV nuk ishin prezantuar saktë, pasi disa raste gjyqësore nuk ishin klasifikuar dhe vlerësuar drejt.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

**Konkluzion për pajtueshmërinë**

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Obiliqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A4 Komuna kishte rekrutuar pozita me afat të caktuar të paplanifikuara dhe kishte realizuar pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Po ashtu, në arsim janë evidentuar 26 raste ku kontratat e punës nuk ishin nënshkruar nga Kryetari i Komunës.
- A5 Gjatë zbatimit të kontratës për Koogjenerim, Komuna kishte bërë devijime nga projekti fillestar pa ndryshim formal të kontratës, ndonëse këto kishin ndikuar në strukturën e pozicioneve kontraktuale. Po ashtu, shërbimet shtesë të mbikëqyrjes prej 31,215€ ishin pranuar pa aneks-kontratë.
- A6 Në procedurat e prokurimit janë identifikuar mangësi në përgatitjen e dosjeve të tenderit dhe vlerësimin e ofertave.
- A7 Komuna kishte tejkaluar vlerën e kontraktuar të furnizimeve me dru për 43,206€. Vlera e përcaktuar e furnizimit me kontratë ishte prej 260,694€ për dru, ndërsa furnizimet ishin në vlerë 303,900€.
- B3 Komuna nuk kishte siguruar menaxhim të mjaftueshëm të kontratave për investime kapitale, pasi katër projekte nuk ishin realizuar brenda afateve të përcaktuara kontraktuale, edhe përkundër shtyrjes së afateve. Në disa raste mungonin dëshmitë për progresin e punimeve, pagesat me kohë ndaj operatorëve ekonomikë dhe planet e qarta për vazhdimin dhe përfundimin e projekteve.
- A8 Komuna nuk kishte menaxhuar në mënyrë të duhur pronat e paluajtshme të dhëna në shfrytëzim, pasi në disa raste shfrytëzuesit nuk kishin respektuar kushtet kontraktuale.
- B4 Komuna nuk kishte kryer monitorim të mjaftueshëm pas dhënies së subvencioneve dhe nuk ishte siguruar që raportimi i përfituesve të jetë i mbështetur me dëshmi përkatëse.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Obiliqit.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Obiliqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Obiliqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Obiliqit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: pasuritë, investimet kapitale, mallrat dhe shërbimet, procedurat e prokurimit, menaxhimin e pronave të paluajtshme, llogaritë e arkëtueshme dhe obligimet.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre tetë janë rekomandime të reja dhe shtatë të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Prezantim jo i saktë i pasurisë në PFV

##### Gjetja

Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Ndërsa, sipas nenit 24, pikës 2, raportimi dhe paraqitja e pasurive në pasqyrat vjetore financiare duhet të bëhet nga: SIMFK-ja për pasuritë mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe E- pasuria për pasuritë me vlerë nën 1,000€ dhe afat të përdorimit mbi një vit dhe stoqet.

Komuna nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive në Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) për vitin 2025. Si rezultat, mangësitë e identifikuara janë si vijon:

- Në 13 raste, situacionet në vlerë totale prej 2,130,174€, për pasuritë e përfunduara nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive. Prej tyre 586,500€ janë pasuri të realizuara përmes projekteve me bashkëfinancim, ndonëse për këto projekte është bërë pranimi teknik dhe ishin në përdorim nga komuna, mirëpo procesi i bartjes nuk ishte realizuar ende.
- Dy pasuri në vlerë prej 324,729€ figuronin si pasuri në përdorim, mirëpo për to nuk ishte aplikuar zhvlerësimi në vlerë prej 30,121€.
- Përveç kësaj, komuna nuk kishte prezantuar saktë vlerën e pasurive prej 37,577€, pasi të njëjtat ishin regjistruar dy herë: si pasuri kapitale në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ dhe njëkohësisht në regjistrin e pasurive nën 1,000€. Si rezultat, vlera e pasurive është mbivlerësuar për këtë shumë.

- Për më tepër Komuna nuk kishte kryer inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive jofinanciare për vitin 2025, siç kërkohet me nenet 19.4 dhe 20 të Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Si rezultat, janë identifikuar mangësi në evidentimin e pasurive, ku 10 pasuri në vlerë 47,388€ figuronin si stoqe, ndonëse ishin pasuri në përdorim dhe të zhvlerësuara tërësisht, ndërsa tri pasuri në vlerë 9,858€ figuronin si stoqe, edhe pse i përkisnin periudhave të mëhershme dhe duhej të trajtoheshin si pasuri jashtë përdorimit.

Mos regjistrimi i pasurive kishte ndodhur për shkak të mungesës së koordinimit të veprimeve konkrete të Komunës dhe Institucioneve përkatëse. Gjithashtu, mangësitë në raportimin e pasurive lidhen me mungesën kontrollit të brendshëm dhe të trajnimeve për zyrtarët e pasurisë në përdorimin e sistemit e-Pasuria.

#### **Ndikimi**

Mangësitë e identifikuar ndikojnë në prezantim jo të plotë dhe të saktë të pasurive në PFV. Njëkohësisht, kjo rrit rrezikun e mosregjistrimit në kohë nga institucionet përfituese dhe krijon mospërputhje ndërmjet regjistrave. Si pasojë, dobësohet kontrolli mbi pasurinë publike dhe vështirësohet përcaktimi i përgjegjësisë për menaxhimin e saj.

#### **Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të sigurojë që përmes zyrtarëve përgjegjës të bëhet analizë e plotë e pasurive komunale, të identifikohen dhe regjistrohen të gjitha situacionet e paregjistruara, si dhe të ndërmerren veprime për bartjen dhe regjistrimin e pasurive të financuara nga institucionet tjera për komunën. Po ashtu, duhet të sigurohet që procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jofinanciare të kryhet në fund të çdo viti. Gjithashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme për të siguruar regjistrim dhe raportim të saktë të pasurive në regjistrat përkatës dhe në PFV.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Mos përditësimi i regjistrit të pasurive për pronat e paluajtshme ndër vite**

##### **Gjetja**

Rregullorja MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 6.1, përcakton se çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnojë regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për secilën pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Gjithashtu, neni 13 i Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastrën e Pronës së Paluajtshme përcakton se ushtrimi i detyrave administrative në fushën e kadastrit dhe regjistrimit të paluajtshmërive në nivel komunal realizohet nga Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK), ndërsa ZKK-të janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e shënimeve kadastrale. Ndërsa neni sipas nenit 24.2, ZKK është e obliguar që sipas detyrës zyrtare të bëjë ç' regjistrimin e njësisë së rrënuar.

Komuna nuk kishte përditësuar regjistrin e pasurive jo financiare dhe nuk kishte harmonizuar të dhënat e këtij regjistri me të dhënat e regjistrit kadastral, lidhur me ndryshimet e ndodhura ndër vite për pronat e paluajtshme. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Në regjistrin e pasurive janë evidentuar 135 parcela në vlerë prej 7,129,043€, të cilat, sipas të dhënave të regjistrit kadastral, nuk figurojnë në emër të Komunës, por rezultojnë me emërtime të ndryshme pronësore. Prej tyre, 51 parcela figurojnë të regjistruara në emër të bashkësive të fshatrave, 20 prona në pronësi të Komunës së Prishtinës, 15 prona janë shpronësuar, ndërsa pjesa tjetër e pronave kanë pësuar ndryshime kadastrale. Për më tepër katër objekte, përkatësisht Objekti i Komunës së Obiliqit, Biblioteka e Qytetit, Shtëpia e Kulturës dhe Shkolla e Mesme "Ismail Dumoshi", nuk janë të evidentuara në regjistrin kadastral, përderisa të njëjtat figurojnë në regjister të pasurisë.
- Në anën tjetër, në regjistrin kadastral janë evidentuar 114 parcela dhe një objekt, përkatësisht Objekti i QKMF-së, të cilat figurojnë në pronësi të Komunës, mirëpo nuk janë të përfshira në regjistrin e pasurive të komunës.
- Gjithashtu, 11 objekte/lokale vazhdojnë të figurojnë në regjistrin kadastral si pronë e komunës, ndonëse ato janë rrënuar dhe nuk ekzistojnë më fizikisht.

Mungesa e koordinimit ndërmjet njësive përgjegjëse, mos azhurnimi periodik i evidencave dhe mungesa e kontroleve sistematike mbi regjistrimin e pasurive kanë ndikuar në krijimin e këtyre mospërputhjeve.

#### **Ndikimi**

Mos përditësimi i regjistrit të pasurive ka ndikuar që vlera e pasurive të mos prezantohet saktë në PFV. Përveç kësaj, mos mbajtja e evidencës së plotë e pasurive, mund të krijojë rrezik për humbjen ose kontestimin e të drejtës pronësore, dhe të ekspozojë institucionin ndaj rreziqeve ligjore dhe financiare.

#### **Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për trajtimin dhe rregullimin e çështjeve pronësore të Komunës, si dhe përditësimin e regjistrit të pasurive dhe evidencave kadastrale në përputhje me gjendjen aktuale, në mënyrë që evidencat e pasurive të jenë të plota, të sakta dhe të harmonizuara me regjistrat kadastrale përkatës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim**

##### **Gjetja**

Rregullorja MF nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 11 paragrafi 1 dhe 3 përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim.

Komuna nuk kishte prezantuar saktë pasuritë në regjistrat përkatës, pasi disa projekte të përfunduara dhe të pranuar teknikisht vazhdonin të figuronin si investime në vijim. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Pesë projekte në vlerë totale prej 646,653€, për të cilat ishte kryer pranimi teknik dhe të njëjtat ishin vënë në përdorim, vazhdonin të figuronin si investime në vijim. Si rezultat, për këto pasuri nuk ishte aplikuar zhvlerësimi sipas kërkesave të rregulloreve përkatëse, duke ndikuar në mbivlerësimin e pasurive për 11,526€.

- Në dy raste tjera, projektet kishin përfunduar dhe ishte kryer pranimi teknik, mirëpo zhvlerësimi ishte aplikuar vetëm për disa situacione, ndërsa pjesa tjetër kishte mbetur e regjistruar si investim në vijim. Në rastin e parë, nga vlera totale e projektit prej 179,326€, situacionet në vlerë prej 96,744€ figuronin ende si investim në vijim, për të cilat zhvlerësimi i paaplikuar ishte 14,511€. Në rastin e dytë, nga vlera totale e projektit prej 1,088,087€, situacionet në vlerë prej 548,087€ figuronin si investim në vijim, për të cilat zhvlerësimi i paaplikuar ishte 28,546€.

Mangësitë e identifikuar lidhur me pasurinë e regjistruar si investime në vijim kanë ndodhur për shkak të kontrollit të dobët dhe mos koordinimit të zyrtarit të pasurisë dhe drejtorive përkatëse për investime kapitale në zbatimin e drejtë të rregullores për menaxhimin e pasurisë.

#### **Ndikimi**

Mosmbyllja e investimeve në vijim dhe mosregjistrimi i tyre si pasuri në përdorim ka rezultuar në mosaplikimin e zhvlerësimit sipas kërkesave ligjore, duke ndikuar mbivlerësimin e pasurive.

#### **Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha projektet e përfunduara dhe të pranuar teknikisht të mbyllen në regjistrat përkatës të pasurive dhe të transferohen nga investimet në vijim në pasuri në përdorim. Po ashtu, duhet të sigurohet që për këto pasuri të aplikohet zhvlerësimi nga momenti i vënies në përdorim.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Keqklasifikim i shpenzimeve**

##### **Gjetja**

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332, neni 15 paragrafi 12, përcakton se ndarjet buxhetore nga rezervat me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për përmbushjen e vendimeve përfundimtare gjyqësore dhe vendimeve të Zyrtarit Kryesor Administrativ.

Po ashtu, bazuar në Qarkoren Buxhetore Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), pika 3 përcakton se kufijtë buxhetorë për komunat, në kolonën e rezervave komunale, duhet të ndahen për përmbushjen e detyrimeve kontingjente, duke i mbajtur brenda kufijve të ndarë buxhetorë dhe duke përjashtuar kategorinë e pagave dhe mëditjeve.

Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike", shpenzimet duhet të kodohen në mënyrë adekuate sipas Udhëzimit Administrativ për Planin Kontabël. Në Planin Kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve, të cilat obligohen të zbatohen nga organizatat buxhetore.

Gjatë auditimit kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve ndërmjet kategorive ekonomike në vlerë totale prej 1,911,816€. Prej kësaj shume, 1,626,610€ ishin ekzekutuar përmes procedurave të përmbartimit, ndërsa pjesa tjetër prej 285,206€ ishte ekzekutuar drejtpërdrejt nga Komuna. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Shuma prej 1,429,172€ ishte ekzekutuar për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive për paga jubilarë dhe shpërblime. Këto obligime ishin paguar nga kategori jo përkatëse buxhetore, përkatësisht 1,310,967€ nga kategoria e investimeve

kapitale, 86,436€ nga kategoria e mallrave, shërbimeve dhe komunalive, si dhe 31,769€ nga kategoria e subvencioneve.

- Shpenzimet në vlerë prej 146,877€, të cilat për nga natyra i përkisnin investimeve kapitale, të cilat ishin paguar nga kategoria e mallrave shërbime dhe komunalit në vlerë 98,477€ dhe nga kategoria e subvencioneve 48,400€.
- Shpenzime në vlerë prej 50,561€, të cilat për nga natyra i përkisnin mallrave dhe shërbimeve, ishin paguar nga kategoria investimet kapitale në vlerë 15,561€ dhe 35,000€ nga subvencionet.
- Për më tepër Komuna, gjatë vitit 2025, pagesat për punëtorët e angazhuar me kontratë për periudhë të caktuar, në vlerë prej 170,308€, kishte realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime, ndonëse për nga natyra i përkasin kategorisë paga dhe mëditje. Ndërsa shume e paguar 114,898€ ishte realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime të cilat i përkasin kategorise se investimeve kapitale.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit buxhetor, si dhe vonesave në pagesën e obligimeve në kohë.

|                       |                                                                                                                                                                                                |
|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Ndikimi</b>        | Keqklasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve, duke shkaktuar prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në raportin vjetor financiar.   |
| <b>Rekomandimi B2</b> | Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuatë, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e saktë të tyre në PFV. |

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontingjente në PFV**

|               |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Gjetja</b> | Rregullorja e Ministrisë së Financave nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar përcakton se Organizatat Buxhetore (OB) mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Sipas nenit 18 të kësaj rregullore OB duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente. |
|---------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|

Vlera e detyrimeve kontingjente e shpalosur në PFV nuk ishte e saktë, si rezultat e mangësive në vijim:

- Në një rast, padia në vlerë prej 13,497€ ishte prezantuar si detyrim kontingjent, edhe pse procesi gjyqësor kishte përfunduar dhe lënda ishte raportuar si obligim i pa paguar.
- Në dy raste, vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore, sipas dokumentacionit mbështetës, ishte 762,847€, ndërsa në PFV ishte prezantuar në vlerë prej 601,000€. Si rezultat, detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 161,847€.
- Ndërsa, në një rast tjetër, vlera e pretendimit gjyqësor ishte 268,420€ ndërsa në PFV ishte prezantuar 282,420€, duke rezultuar në mbivlerësim të detyrimeve për 14,000€.

Kontrollet e brendshme joefektive, ndryshimi i stafit në departamentin ligjor,

si dhe numri i madh i lëndëve, kanë ndikuar në mos përditësimin e regjistrit të detyrimeve kontingjente.

**Ndikimi**

Prezantimi jo i plotë i detyrimeve kontingjente ndikon që PFV-të të mos prezantojnë gjendjen e drejtë dhe saktë të tyre.

**Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të siguroj një kontroll dhe koordinim më efektiv në mes zyrës ligjore dhe përfaqësuesit ligjor të komunës me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontingjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informata, dhe që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A4 - Dobësi në planifikimin e personelit dhe administrimin e kontratave të punës

#### Gjetja

Ligji nr. 08/L-197, neni 16, përcakton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka kompetencë të përgatisë planin vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit. Po ashtu sipas nenit 17.1, çdo institucion që punëson zyrtarë/ë publik, përgatit planin vjetor të personelit në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor. Si neni 17.2, plani vjetor i personelit përmban nevojat për personel kompetent dhe cilësor në arritjen e misionit dhe objektivave të institucionit. Tutje, neni 82.3 i Ligjit nr. 08/L-197 përcakton se NjMBNj përgatit kontratën e punës, që nënshkruhet nga organi emërues dhe kandidatja/i fituese. Po ashtu, Neni 17 i Ligjit 08/L-294 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 08/L-197 Për Zyrtar Publik, neni 102.4. Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik.

Gjatë auditimit janë identifikuar dobësi në procesin e planifikimit të personelit dhe administrimit të kontratave të punës, të cilat janë paraqitur si në vijim:

- Komuna gjatë vitit 2025 kishte zhvilluar procese të rekrutimit për 14 pozita të punës, të cilat nuk ishin planifikuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Po ashtu, edhe gjatë vitit të kaluar ishte aplikuar praktikë e njëjtë, ku ishin rekrutuar 16 pozita të punës. Si rrjedhojë e këtyre rekrutimeve, gjatë vitit 2025 komuna kishte realizuar pagesa për punonjës nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë totale prej 170,308€, në vend që këto shpenzime të planifikoheshin dhe buxhetoheshin në kategorinë përkatëse të pagave dhe mëditjeve.
- Gjatë vitit 2025 për punonjësit e tri shkollave fillore ("Dosidej Obrodovic", "Milan Rakic" dhe "Sveti Sava") janë evidentuar 26 raste ku kontratat e punës ishin nënshkruar nga Nënkryetari i Komunës, ndonëse bazuar edhe në interpretimin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, nënshkrimi i kontratave të punës bëhet nga Kryetari i Komunës. Nga këto raste, 15 punonjës ishin angazhuar me kontratë me afat të pacaktuar (të njëjtit deri në vitin 2025 ishin të angazhuar me afat të caktuar), ndërsa 11 punonjësve i janë vazhduar kontratat e punës me afat të caktuar deri në vitin 2026. Edhe pse kontratat ishin protokolluar më 05.12.2025, ato mbulonin periudhën nga 01.09.2025, çka tregon se angazhimi gjatë periudhës shtator-nëntor ishte realizuar pa dokumentacion kontraktual të rregullt.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i planifikimit jo adekuat të nevojave për staf, mungesës së parashikimit buxhetor dhe koordinimit ndërmjet njësive përgjegjëse. Ndërsa, nënshkrimi i kontratave nga zyrtari jo kompetent ishte rezultat i mosrespektimit të kërësave ligjore.

#### Ndikimi

Rekrutimi i pozitave të paplanifikuara dhe pagesa e punonjësve nga kategori jo adekuate ekonomike ka ndikuar në klasifikimin jo të saktë të

shpenzimeve dhe në dobësimin e kontrollit mbi planifikimin e personelit dhe buxhetit për paga. Po ashtu, mosrespektimi kërkesave ligjore me rastin e nënshkrimit të kontratave ndikon në përgjegjësitë e menaxhmentit të komunës si dhe krijon precedent të angazhimeve të tilla me ndikim financiar.

#### **Rekomandimi A4**

Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi i nevojave për staf të bëhet në përputhje me planin vjetor të personelit dhe procesin buxhetor, si dhe që pagesat për punonjës të realizohen nga kategoritë përkatëse ekonomike. Po ashtu, duhet të sigurojë forcimin e kontroleve në procesin e nënshkrimit dhe aprovimit të kontratave të punës, në mënyrë që ato të nënshkruhen vetëm nga zyrtarët kompetentë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A5 - Mos amandamentimi i kontratës**

##### **Gjetja**

Neni 71.1 i Rregullores për Prokurim nr. 001/2022 me plotësim ndryshime ndër të tjera, përcakton se Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer. Menaxheri i kontratës rekomandon ndryshimin e kontratës duke përfshirë edhe arsyet për ndryshimin e kontratave ku ndryshimi i kontratës kërkon ndryshim të projektit dhe/apo specifikimeve teknike. Menaxheri i kontratës merr aprovimin paraprak të projektuesit të cilin ia bashkëngjitet rekomandimet për ndryshim. Tutje, sipas nenit 71.9 ii) Në rast të kontratave për punë, kur ndryshimi i kontratës nuk ka kosto financiare shtesë, duhet të iniciohet procedura për amandamentimin e kontratës. Aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termeve dhe kushteve fillestare, amandamentimi do të përgatitet nga Njësia e Prokurimit dhe duhet të nënshkruhet nga nënshkruesit e kontratës bazë. Tutje, Neni 54.15 përcakton se kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Në kontratën "Koogjenerimi - Shtrirja e Rrjetit të Sistemit të Ngrohjes Qendrore - Obiliq" në vlerë prej 11,849,684€ të nënshkruar me 30.11.2022, është vërejtur se komuna gjatë realizimit të kontratës kishte bërë ndryshime apo devijime të projektit, mirëpo nuk kishte bërë ndryshimin e kontratës siç kërkohet me rregulloren e prokurimit.

Devijimet kryesore përfshijnë ndryshimin e trasesë së gypave për anashkalimin e sheshit të qytetit, i cili nuk ishte i paraparë në projektin fillestar, duke kërkuar ri-dizajnim të rrjetit, analiza statike dhe ri-balancim hidraulik, si dhe përfshirjen e pesë segmenteve të reja rrugore me kërkesë të Komunës së Obiliqit, si dhe largimin e dy segmenteve ekzistuese për shkak të çështjeve pronësore private.

Si rrjedhojë e këtyre ndryshimeve janë evidentuar tejkalime në mbi 130 pozicione kontraktuale, me variacione nga 33% deri në 12,083%, megjithatë pa tejkalim të vlerës totale të kontratës. Pavarësisht këtyre ndryshimeve në përmbajtjen e kontratës dhe strukturën e pozicioneve, nuk është siguruar aprovimi i ndryshimeve nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe nuk është formalizuar asnjë procedurë e amandamentimit të kontratës.

Përveç kësaj, për realizimin e punëve tjera shtesë ishte lidhur aneks-kontratë, ku pozicionet dhe çmimet ishin realizuar sipas kushteve kontraktuale. Megjithatë, lidhur me këto punë shtesë nuk ishte lidhur aneks për kontratën e mbikëqyrjes së punimeve, e cila ishte kontratë kornizë me çmime për njësi. Si rezultat, janë pranuar dhe njohur si obligime shërbime të mbikëqyrjes në vlerë prej 31,215€, pa u formalizuar paraprakisht baza kontraktuale që do të mbulonte këto shërbime shtesë.

Shkak për këtë ishte mungesa e mjaftueshme e kontrolleve të brendshme gjatë realizimit të kontratës, ku ndryshimet janë trajtuar vetëm përmes të takimeve të mbajtura në mes OE dhe AK.

**Ndikimi** Mos amandamentimi i kontratës rrit rrezikun që projekti të mos realizohet sipas qëllimit të paraparë si dhe dobëson kontrollin mbi menaxhimin e kontratës.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të sigurojë që çdo ndryshim gjatë zbatimit të kontratës, pavarësisht natyrës së tij financiare apo teknike, të formalizohet përmes procedurës së amandamentimit të kontratës në përputhje me kërkesat rregullative në fuqi, me qëllim të dokumentimit të plotë të ndryshimeve dhe sigurimit të përputhshmërisë mes kontratës dhe realizimit në terren.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A6 - Mangësi në procedurat e prokurimit**

**Gjetja** Sipas Nenit 60, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, autoriteti kontraktues duhet t'ia japë kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm. Tutje, sipas nenit 68 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimit Publik, në përcaktimin e qarkullimit minimal, autoritetet kontraktuese nuk duhet të kalojnë dy herë vlerën e parashikuar të kontratës. Kur, përveç qarkullimit minimal, një qarkullim i caktuar minimal në fushat specifike të mbuluara nga kontrata është i nevojshëm, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë 1.5 herë vlerën e parashikuar të kontratës. Ndërsa neni 54.15 i Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, përcakton se kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit janë identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në procedurën "Vaksinimi dhe trajtimi i qenve endacakë", me vlerë 107,160€, në dosjen e tenderit ishte kërkuar që operatorët ekonomikë të dispononin tre teknika të veterinarisë me së paku dy vite përvojë pune nga data e diplomimit. Ndërsa, për dy teknikat e veterinarisë dëshmitë e ofruara nga OE fitues nuk vërtetonin përmbushjen e kriterit për përvojën e kërkuar. Përkundër kësaj, komisioni i vlerësimit e kishte vlerësuar ofertën si të përgjegjshme dhe kishte rekomanduar dhënien e kontratës.

- Në procedurën e prokurimit “Furnizim me pajisje bujqësore”, me vlerë të parashikuar 123,350€, dosja e tenderit nuk ishte në harmoni të plotë me kërkesat e LPP-së. Konkretisht, ishte kërkuar që operatorët ekonomikë të kenë qarkullim në tri vitet e fundit në vlerë jo më pak se 300,000€, ndërsa kufiri maksimal i lejuar ishte 246,700€. Po ashtu, ishte kërkuar dëshmi për furnizime të ngjashme në vlerë 350,000€, ndërsa kufiri maksimal i lejuar ishte 185,025€.
- Në dosjen e tenderit për projektin “Asfaltimi i rrugës të Sekiraqt në Mazgit dhe rruga Dardania, Ndërtimi i rrugës dhe trotuarit në rr. Daut Hashani, Ndërtimi i kanalit Breznicë dhe Ndërtimi i këndeve të lojërave afër fushave sportive në Dardhishtë”, Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar që operatorët ekonomikë t'i posedojnë pajisjet dhe mekanizimin e kërkuar dhe që për to të dorëzojnë dëshmi të pronësisë (libreza ose DUD doganor, ndonëse operatori ekonomik fitues kishte dëshmuar disponueshmërinë e dy pajisjeve përmes marrëveshjeve për shfrytëzim të makinerive me një operator tjetër ekonomik, edhe pse në dosjen e tenderit nuk ishte paraparë mundësia e përdorimit të pajisjeve në bazë të marrëveshjeve të qirasë apo shfrytëzimit nga operatorë të tjerë ekonomik.
- Për procedurën “Mbikëqyrja profesionale e sistemit të Kogjenerimit - vazhdimi i punimeve”, Komuna kishte nënshkruar kontratë publike kornizë me çmim për njësi në vlerë të parashikuar 345,000€, duke përfshirë edhe devijimin +/-30%, në kundërshtim me kërkesat e rregullores së prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit dhe vlerësimit të ofertave, si dhe moszbatimit të plotë të kërkesave ligjore për hartimin e specifikimeve teknike dhe verifikimin e përgjegjshmërisë së ofertave.

#### **Ndikimi**

Përcaktimi i kriterëve jo proporcionale dhe vlerësimi si i përgjegjshëm i ofertës pa dëshmi të mjaftueshme, rrisin rrezikun për kufizim të konkurrencës, trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe dhënie të kontratave operatorëve që nuk i plotësojnë plotësisht kërkesat e dosjes së tenderit.

#### **Rekomandimi A6**

Kryetari duhet të sigurojë se gjatë përgatitjes së dosjeve të tenderit dhe vlerësimit të ofertave, zyrtarët përgjegjës zbatojnë plotësisht kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A7 - Tejkallim i kontratës për furnizim me dru**

**Gjetja** Rregullorja Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 54.15, përcakton: Kur Autoriteti Kontraktues nuk di sasinë indikative, kontratat me çmim për njësi, AK duhet të përcaktojë peshën në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull”, në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktojë se cila është oferta me çmimin më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë për qind (30%). Në hapjen publike të ofertave lexohet çmimi total i ponderuar (i peshuar), i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave, ndërsa kontrata lidhet me çmim për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerën e parashikuar. Po ashtu, sipas interpretimit të Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) të datës 09.06.2023, gjatë realizimit të Kontratës Publike Kornizë, ofruesi i shërbimeve faturimin e bën duke u bazuar në shërbimet e kryera dhe çmimet për njësi të shërbimeve të kontratës (jo çmimet e peshuara), por nuk lejohet të kalohet vlera sipas kategorive dhe vlera totale e parashikuar.

Komuna me datë 17.01.2025 kishte lidhur kontratë kornizë për tri vite "Furnizimi me Dru dhe Pelet për të gjitha Insitucionet Edukativo Arsimore, Kulturore dhe Shëndetësore në Komunën e Obiliqit" në vlerë 372,420. Sipas kontratës, ishte përcaktuar që furnizimi me dru të realizohet 70% të vlerës së kontratës, përkatësisht 260,694€, ndërsa furnizimi me pelet në 30%, përkatësisht 111,726€. Ne kemi identifikuar, që furnizimi me dru vetëm në vitin 2025 kishin arritur vlerën 303,900€, duke tejkaluar vlerën e përcaktuar të furnizimit me dru për 43,206€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i monitorimit jo adekuat të realizimit të kontratës nga menaxheri i kontratës dhe zyrtarët përgjegjës, si dhe mungesës së kontrolleve efektive për të siguruar që furnizimet të realizohen brenda vlerave të përcaktuara sipas kontratës.

**Ndikimi** Tejkallimi i furnizimeve përveç që është në kundërshtim me kushtet e kontratës, duke rezultuar me menaxhim jo efektiv të kontratës dhe fondeve publike.

**Rekomandimi A7** Kryetari duhet të sigurojë që procesi i menaxhimit të kontratave të monitorohet në mënyrë pro aktive, me qëllim që procesi i zbatimit të kontratës të realizohet sipas kushteve kontraktuale.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B3 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara**

**Gjetja** Neni 9.2 i Ligjit Nr 04/L-042 për prokurimin publik përcakton se “nëse pas vlerësimit të nevojave, Zyrtari Kryesor Administrativ vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, Zyrtari Kryesor Administrativ i dërgon një kopje të këtij vlerësimi Zyrtarit Kryesor Financiar të autoritetit kontraktues. Zyrtari Kryesor Financiar siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë.

Realizimi i kontratave për investime kapitale nuk ishte bërë sipas afateve të

përcaktuara kontraktuale. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

- Komuna e Obiliqit me datën 10.11.2023 kishte lidhur memorandum të bashkëpunimit me Shoqatën Ekonomiko-Kulturore “Qëndresa Kosovare” për financimin e projektit “Renovimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Obiliq” në shumë prej 500,000€. Sipas memorandumit, shuma 110,000€ do të financohet nga komuna ndërsa pjesa tjetër nga Shoqatën Ekonomiko-Kulturore e cila kishte zhvilluar edhe procesin e kontraktimit. Kontraktimi i këtij projekti ishte bërë me 14.11.2023 dhe afati kohor për realizim ishte 180 ditë. Me datë 20.08.2024 Komuna kishte transferuar në llogari të Shoqatës shumën prej 55,000€ për punët e kryera që ndërlidhën me realizimin e projektit.

Përmes ekzaminimit fizik kemi vërejtur që projekti nuk ishte përfunduar plotësisht ngase objekti ishte në përdorim vetëm në katin përdhes, ndërsa pjesa tjetër e objektit nuk ishte funksionale. Objekti nuk kishte kulm të përfunduar, kurse dy katet e sipërme ndodheshin ende në fazë ndërtimore, kryesisht vetëm me strukturë të mureve.

Lidhur me këtë kemi kërkuar sqarime nga komuna mirëpo sipas tyre, edhe përkundër përpjekjeve për tu informuar nga Shoqata lidhur me realizimin e projektit, një gjë e tillë nuk ishte arritur.

Për më tepër, në të njëjtin objekt gjatë vitit 2025 kishte investuar edhe Ministria e Shëndetësisë përmes projektit “Renovimi i katit përdhes dhe ndërtimi i ashensorit në QKMF Obiliq”, në vlerë prej 38,856€.

- Projekti “Ndërtimi i dy nënkalimeve për këmbësorë”, në vlerë prej 429,348€, nuk ishte realizuar brenda afateve të përcaktuara kontraktuale. Kontrata ishte nënshkruar më 19.07.2023, me afat ekzekutimi prej 120 ditësh nga data e nënshkrimit. Për shkak të problemeve me infrastrukturën nëntokësore, menaxheri i kontratës kishte kërkuar shtyrje të afatit, e cila ishte aprovuar deri më 08.12.2023. Megjithatë, edhe pas kësaj shtyrjeje, projekti nuk ishte përfunduar. Për më tepër, më 19.11.2025 ishte bërë edhe një shtyrje tjetër e afatit deri më 30.06.2026, me arsyetimin e kushteve atmosferike dhe vonesave në pagesat e komunës ndaj operatorit ekonomik.
- Projekti “Asfaltimi i rrugës te Sekiraqt në Mazgit dhe rruga Dardania, ndërtimi i rrugës dhe trotuarit në rr. Daut Hashani, ndërtimi i kanalit në Breznicë dhe ndërtimi i këndeve të lojërave afër fushave sportive në Dardhishtë”, në vlerë prej 99,999€, nuk ishte realizuar sipas planit dinamik të përcaktuar. Kontrata ishte lidhur më 15.08.2025, me afat realizimi prej 90 ditësh, mirëpo deri në periudhën e auditimit ishte realizuar vetëm situacioni i parë në vlerë 50,000€. Menaxheri i kontratës kishte kërkuar shtyrje të afatit të planit dinamik, me arsyetimin e mungesës së mjeteve buxhetore. Për më tepër, projekti nuk ishte përfshirë në planet buxhetore të viti 2026 për vazhdimin e realizimit të tij.
- Projektit “Bashkëfinancim - Asfaltimi i rrugëve dhe kanalizimi fekal në fshatin Babimoc”, në vlerë prej 216,976€, nuk ishte realizuar sipas planit dinamik të përcaktuar. Kontrata ishte lidhur më 23.05.2024, me afat realizimi prej 120 ditësh, mirëpo gjatë zbatimit të saj ishin paraqitur pesë kërkesa për shtyrje të afatit. Si rezultat, përfundimi i projektit ishte paraparë të realizohet deri më 30.06.2026, duke tejkaluar ndjeshëm afatin fillestar të realizimit.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i planifikimit dhe monitorimit jo të mjaftueshëm të projekteve kapitale, mungesës/vonesave në sigurimin e mjeteve buxhetore dhe pagesave ndaj operatorëve ekonomik.

#### **Ndikimi**

Mosrealizimi i projektit investiv sipas marrëveshjes me Shoqatën ka ndikuar që edhe përkundër pagesave të realizuar nga komuna të mos arrihet qëllimi i synuar i projektit. Tutje, mangësitë lidhur me vonesat në realizim të projekteve ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës dhe në mirëqenien e qytetarëve.

#### **Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit së pari të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për financimin e projekteve. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A8 - Menaxhim jo i duhur i pronave të paluajtshme të dhëna në shfrytëzim**

#### **Gjetja**

Kontrata për dhënen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajshme komunale, neni 9. pika 5. përcakton se: Operatori Ekonomik mund ta përdor pronen vetëm për qëllimin e përdorimit të përshkruar sipas ofertës së negocuar dhe për të gjitha qëllimet tjera të nevojshme për realizimin e qëllimeve të parapara në projekt propozim.

Tutje neni 10. pika 1. Nëse Operatori Ekonomik nuk e realizon projektin e propozuar brenda afatit, duke u bazuar në ofertën e negocuar, komuna gëzon të drejtën e anulimit të njëanshëm të kontratës me vendim.

Komuna nuk kishte menaxhuar në mënyrë të duhur pronat e paluajtshme të dhëna në shfrytëzim afatgjatë (99 vjet). Gjatë auditimit dhe ekzaminimit fizik janë identifikuar gjashtë raste ku operatorët ekonomik nuk kishin respektuar obligimet kontraktuale lidhur me realizimin dhe destinimin e projekteve zhvillimore në prodhim, aktivitete rekreative dhe kultivime bujqësore. Mangësitë janë si në vijim:

- Në një rast, projekti nuk ishte realizuar sipas kontratës mirëpo OE pronën e marrë në shfrytëzim e ishte dhënë me qira tek palë të treta;
- në një rast OE kishte ndryshuar destinimin e projektit në kundërshtim me kushtet e kontratës;
- në një rast tjetër, ndonëse kontrata kishte përfunduar në vitin 2020, OE vazhonte ta ushtronte aktivitetin në atë pronë, si dhe
- në tri raste tjera OE nuk kishin filluar fare realizimin e projekteve të parapara sipas kontratës;

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mosndërmarrjes me kohë të masave ndaj shfrytëzuesve që nuk kanë respektuar kushtet kontraktuale lidhur me realizimin dhe destinimin e projekteve. Edhe për kundër se ka pasur raport për monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e kontratave nga ana e komunës,

#### **Ndikimi**

Mosrespektimi i kushteve kontraktuale për pronat e dhëna në shfrytëzim,

ndikon në mosarritjen e objektivave të komunës për zhvillim ekonomik dhe shfrytëzim efikas të pronës publike.

#### **Rekomandimi A8**

Kryetari duhet të sigurojë monitorim dhe mbikëqyrje më efektive të zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, në mënyrë që projektet të realizohen në përputhje me kushtet dhe destinimin e përcaktuar në kontratë. Gjithashtu, duhet të ndërmerren masa konkrete ndaj shfrytëzuesve që nuk respektojnë obligimet kontraktuale, përfshirë rishikimin ose ndërprerjen e kontratave në rastet e shkeljeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Mangësi në raportimin dhe monitorimin e subvencioneve**

##### **Gjetja**

Neni 4. i marrëveshjes me përfituesit paragrafi 2. Përfituesi është i obliguar ta posedoj pajisjen së paku tre vjet, në të kundërtën Autoriteti kontraktues do të marrë masa, paragrafi 3. Nëse komisioni i drejtorisë konstaton se nuk është përmbushur kontrata, atëherë ka të drejtë për ta marrë pajisjen. Rregullorja nr.1/108 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve në nenin 22 Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve përcakton se „Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet ti këtë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve. Gjithashtu, marrëveshja e bashkëpunimit në mes Komunës dhe Islamic Relief Worldwide (IRW) neni 2 përcakton se fondet e komunës do të transferohen tek IRW, e cila pastaj do të raportoj dhe dëshmoj me faturat e shpenzimeve dhe raportet e shërbimeve të kryera.

Komuna nuk kishte kryer monitorim të mjaftueshëm pas dhënies së subvencioneve, ku janë evidentuar mangësi në raportimin e shpenzimeve dhe në verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse, si në vijim:

- Komuna kishte dhënë subvencion gjatë vitit 2025 në shumë 40,800€ për të mbështetur/subvencionuar Islamic Relief Worldwide (IRW) për realizimin projektit trevjeçar “Kujdesi shtëpiak për lehona, persona të moshës së tretë dhe persona me aftësi të kufizuara”. Sipas marrëveshjes, IRW do duhej të raportoj/dëshmoj me faturat e shpenzimeve dhe raportet e shërbimeve të kryera. Ne kemi identifikuar se IRW nuk kishte bërë raportim të plotë për faktin se kishte dorëzuar vetëm raporte që përmbanin numrin e vizitave mjekësore të realizuara, por nuk kishte raportuar faturat e shpenzimeve për raportet e shërbimeve të kryera.
- Po ashtu, Komuna përmes projektit “Furnizim me pajisje bujqësore” kishte subvencionuar fermerët me pajisje të ndryshme bujqësore në vlerë totale prej 123,100 €. Me rastin e dhënies së subvencioneve, komuna kishte lidhur marrëveshje me përfituesit, ku ishte përcaktuar obligimi për monitorimin e përdorimit të pajisjeve dhe realizimit të objektivave të projektit gjatë periudhës trevjeçare pas përfitimit të subvencioneve. Megjithatë, gjatë auditimit kemi identifikuar se komuna nuk kishte kryer monitorimin e paraparë me marrëveshje.

Projekti përfshinte subvencionimin e 25 përfituesve me freza 1.6 në vlerë prej 24,000 €, 30 përfituesve me pompa spërkatëse për traktor në vlerë prej 17,100 €, 10 përfituesve me mikser për përzierjen e ushqimit në vlerë prej 37,000 €, si dhe 100 përfituesve me motokultivatorë në vlerë prej 45,000 €.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve në monitorimin e subvencioneve, dhe dorëzimit të raporteve narrative dhe financiare nga ana e koordinatoreve përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes.

#### **Ndikimi**

Mungesa e monitorimit të mjaftueshëm dhe raportimit të mbështetur me dëshmi rrit rrezikun që subvencionet të mos shfrytëzohen në përputhje me qëllimin e dhënë dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshje. Kjo gjithashtu kufizon mundësinë e Komunës për të verifikuar realizimin e aktiviteteve, arsyeshmërinë e shpenzimeve dhe efektin real të fondeve publike të dhëna për përfituesit.

#### **Rekomandimi B4**

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve për monitorimin e subvencioneve pas dhënies së tyre, në mënyrë që përfituesit të raportojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshje dhe të ofrojnë dëshmi të mjaftueshme për shpenzimet dhe aktivitetet e realizuara. Po ashtu, duhet të sigurohet që monitorimi të dokumentohet rregullisht, për të verifikuar nëse subvencionet janë shfrytëzuar sipas qëllimit për të cilin janë dhënë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,793,600€, prej tyre në vitin 2025 ishin shpenzuar 5,787,116€.

#### Çështja B5 - Mos përdorimi i sistemit të e-prokurimit për modulën e kontratave

|                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Gjetja</b>         | <p>Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.</p> <p>Komuna nuk ka përdorur sistemin elektronik të prokurimit publik për përgatitjen e planeve të menaxhimit të kontratave, si dhe nuk ka realizuar menaxhimin, administrimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes këtij sistemi, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.</p> <p>Mangësitë e identifikuar janë si pasojë e mungesës së trajnimit të personelit përgjegjës, si dhe mungesa e zbatimit të rregulloreve dhe udhëzimeve operative nga ana e autoritetit kontraktues.</p> |
| <b>Ndikimi</b>        | <p>Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojë në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b>Rekomandimi B5</b> | <p>Kryetari duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e kontratave të mbajnë dhe arkivojnë të gjitha dokumentet e menaxhimit të kontratave në modulën përkatës të sistemit elektronik të prokurimit publik.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna në PVF e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,621,845€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatim në pronë në vlerë 1,233,320 €, të arkëtueshmet nga tarifa biznesore në biznesit në vlerë 107,342€ si dhe nga të arkëtueshmet tjera 281,183€.

### Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme.

#### Gjetja

Neni 26 i Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L- 005 përcakton se: Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Si dhe Regullorja e Ministrisë së Financave nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar përcakton se Organizatat Buxhetore (OB) mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Sipas nenit 16 Raport për të arkëtueshmet Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Llogaritë e arkëtueshme nuk ishin menaxhuar dhe prezantuar saktë, si në vijim:

- Bazuar në konfirmimet e komunës dhe dëshmitë e auditimit, kemi identifikuar raste të mosreflektimit të pagesave të realizuara, si dhe mospërputhje në të dhënat e gjeneruara nga sistemi, çka tregon mangësi në administrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të llogarive të arkëtueshme të regjistrit të komunës.
- Në regjistrin e llogarive të arkëtueshme ishin përfshirë borxhe nga qiraja e pronave të paluajtshme, të cilat ishin që nga viti 2011. Për këto borxhe gjatë vitit 2025 nuk ishte marrë veprime për arkëtimin e tyre, ndërsa në 106 raste bizneset debitore rezultojnë pasive.

Mangësitë e identifikuar janë si rezultat i problemeve të vazhdueshme në funksionimin e sistemit "PROTAX", ku janë vërejtur vazhdimisht gabime në paraqitjen e gjendjes së borxhit për tatimpaguesit dhe mungesës së monitorimit dhe veprimeve për arkëtimin e borxheve.

#### Ndikimi

Problemet në funksionimin e sistemit mund të ndikojnë që llogaritë e arkëtueshme të mos prezantohen saktë në PVF. Ndërsa mos arkëtimi i borxheve ndikon që komuna të mos realizoj projektet nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë në arritjen e objektivave të komunës.

#### Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë që përmes zyrtarëve përgjegjës të bëjë analizë të plotë të llogarive të arkëtueshme dhe marrjen e veprimeve në mbledhjen e

borxheve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2025, ishte 2,226,902€ . Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2026.

#### Çështja B7 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara

**Gjetja** Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në 10 raste të faturave (obligimeve të papaguara) në vlerë prej 1,666,461€ nuk janë paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat në pesë raste ishin 90 ditë e më shumë, ndërsa në pesë raste të tjera vonesat ishin mbi pesë muaj.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve të mjaftueshme buxhetore, si rezultat i ekzekutimit të një pjese të konsiderueshme të buxhetit përmes procedurave përmbartimore, çka ka ndikuar në pamundësinë e realizimit të pagesave të faturave sipas afatit ligjor.

**Ndikimi** Vonesat në kryerjen e obligimeve mund të ndikojnë që këto obligime të realizohen përmes procedurave gjyqësore të cilat mund të shkaktojnë kosto shtesë, përveç vlerës së faturës, kamatën dhe shpenzimet tjera procedurale gjyqësore/përmbartimore.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të përmirësojë performancën e menaxhimit të fondeve, dhe të bëjë planifikim të mirëfilltë, për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmangët shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                   | Buxheti fillestar | Buxheti final <sup>5</sup> | 2025<br>Shpenzimet | 2024<br>Shpenzimet | 2023<br>Shpenzimet |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <b>Burimet e fondeve</b>     | <b>14,516,132</b> | <b>15,467,456</b>          | <b>15,389,489</b>  | <b>14,653,892</b>  | <b>14,117,020</b>  |
| Grante Qeveritare - Buxheti  | 13,224,544        | 13,561,098                 | 13,547,432         | 13,153,929         | 12,470,533         |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0                 | 201,565                    | 201,565            | 194,097            | 312,876            |
| Të hyrat vetanake            | 1,291,588         | 1,541,588                  | 1,498,034          | 1,031,408          | 942,285            |
| Donacionet vendore           | 0                 | 700                        | 0                  | 0                  | 30                 |
| Donacionet e jashtme         | 0                 | 162,506                    | 142,458            | 274,457            | 391,296            |

Buxheti final i Komunës së Obiliqit është më i lartë se buxheti fillestar për 951,324€. Kjo rritje e buxhetit është i rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 336,554€, rritjes së të hyrave vetanake për 250,000€, përfshirjes së të hyrave të bartura prej 201,564€ dhe donacioneve në vlerë prej 163,205€, në buxhet final.

Deri në fund të vitit 2025 Komuna ka shpenzuar 15,389,489€, përkatësisht 99.5% e buxhetit final. Krahëuar me vitin 2024, shpenzimet janë rritur për 735,597€ ose 5%. Komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbartimore ju kanë ekzekutuar 1,814,947€ nga kategori të ndryshme ekonomike.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi                                             | Buxheti fillestar | Buxheti final     | 2025<br>Shpenzimet | 2024<br>Shpenzimet | 2023<br>Shpenzimet |
|--------------------------------------------------------|-------------------|-------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b> | <b>14,516,132</b> | <b>15,467,456</b> | <b>15,389,489</b>  | <b>14,653,892</b>  | <b>14,117,020</b>  |
| Pagat dhe mëditjet                                     | 5,767,263         | 6,103,817         | 6,103,780          | 5,587,151          | 5,159,747          |
| Mallrat dhe shërbimet                                  | 1,900,000         | 2,187,514         | 2,117,904          | 1,753,351          | 1,548,521          |
| Komunalitë                                             | 300,000           | 320,000           | 319,711            | 435,757            | 268,622            |
| Subvencionet dhe transferet                            | 1,100,000         | 1,062,525         | 1,060,977          | 1,016,334          | 996,393            |
| Investimet Kapitale                                    | 5,448,869         | 5,793,600         | 5,787,116          | 5,861,299          | 6,143,736          |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje, krahasuar me buxhetin fillestar, ishte rritur për 951,324€. Kjo rritje vjen si rrjedhojë e rritjes së vlerës së koeficientit. Shpenzimi në këtë kategori ishte 99.5%.


Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 287,514€. Nga kjo kategori janë shpenzuar 2,117,904€, ose 96.8%.

Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 20,000€. Rritja ishte nga të hyrat vetanake, ndersa shpenzimi në këtë kategori ishte rreth 100% e buxhetit.

Buxheti final për Subvencionet dhe transferet ishte zvogeluar për 37,475€ në krahasim me buxhetin fillestar. Kjo si rezultat i transferimeve në kategori tjera ekonomike. Shpenzimi në këtë kategori ishte 100%.

Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 344,731€. €. Rritja ishte nga të hyrave vetjake dhe donacionet. Nga buxheti final janë shpenzuar 5,787,116€ ose 100%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025



Të hyrat e planifikuara nga Komuna e Obiliqit në 2025 ishin 1,291,588€ ndërsa ishin realizuar 1,479,965€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

| Përshkrimi                | Buxheti<br>filleshtar | Buxheti<br>final | 2025<br>Pranimet | 2024<br>Pranimet | 2023<br>Pranimet |
|---------------------------|-----------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>Totali i të hyrave</b> | <b>1,291,588</b>      | <b>1,291,588</b> | <b>1,479,966</b> | <b>917,253</b>   | <b>899,270</b>   |
| Të hyrat tatimore         | 687,102               | 687,102          | 545,358          | 445,530          | 449,466          |
| Të hyrat jo tatimore      | 604,486               | 604,486          | 934,608          | 471,723          | 449,648          |
| Të hyrat tjera            | 0                     | 0                |                  |                  | 156              |


## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Komunës së Obiliqit ka rezultuar në nëntë rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, vetëm një rekomandim ishte zbatuar, për shtatë rekomandime nuk ka filluar zbatimi ende, ndërsa në një rast rekomandimi nuk është i zbatuar më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit                          | Rekomandimet e vitit 2024                                                                                                                                                                      | Veprimet e ndërmarra                                                                                                                         | Statusi                 |
|----|--------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|
| 1. | Çështjet e përbashkëta (vendime gjyqësore) | Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e sakët të tyre në PFV. | Edhe këtë vit janë identifikuar raste të keqklasifikimit të shpenzimeve, ku pagesat nuk ishin regjistruar në kategoritë ekonomike përkatëse. | Nuk ka filluar zbatimin |

|    |                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                           |                            |
|----|-----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|
| 2. | Baza për konkluzion         | Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit së pari të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për financimin e projekteve. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.   | Komuna nuk kishte arritur t'i realizojë projektet kapitale sipas planeve dinamike të përcaktuara, edhe përkundër rekomandimit të dhënë në vitin paraprak. | Nuk ka filluar zbatimin    |
| 3. | Baza për konkluzion         | Kryetari duhet të përmirësojë performancën e menaxhimit të fondeve, dhe të bëjë planifikim të mirëfilltë, për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmangët shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.                                                                                      | Edhe këtë vit janë evidentuar vonesa në pagesa dhe raste të pagesave përmes procedurave përmbartimore.                                                    | Nuk ka filluar zbatimin    |
| 4. | Baza për konkluzion         | Kryetari duhet të sigurojë se procedura e prokurimit do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik, dhe kur autoriteti kontaktues nuk mundë ti planifikoj sasi të indikative me çmim për njësi, atëherë nuk duhet të përfshihet në kontratë edhe devijimi +-30%.                                                                       | Është trajtuar në kuadër të çështjes mangësitë në procedurat e prokurimit                                                                                 | Nuk është i aplikueshëm më |
| 5. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e fondeve nga përfituesit. | As gjatë vitit 2025, Komuna nuk kishte siguruar monitorim dhe raportim të mjaftueshëm për shfrytëzimin e subvencioneve.                                   | Nuk ka filluar zbatimin    |
| 6. | Investimet kapitale         | Kryetari duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e kontratave të mbajnë dhe arkivojnë të gjitha dokumentet e menaxhimit të kontratave në modulën përkatës të sistemit elektronik të prokurimit publik.                                                                                                                                                      | Edhe këtë vit, menaxhimi i kontratave nuk ishte realizuar përmes sistemit të e-Prokurimit.                                                                | Nuk ka filluar zbatimin    |
| 7. | Pasuritë                    | Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.                                                                                                                | Edhe këtë vit janë identifikuar raste të investimeve në vijim të cilat nuk ishin mbyllur, pavarësisht rekomandimit të dhënë në vitin paraprak.            | Nuk ka filluar zbatimin    |

|    |                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                             |                        |
|----|-------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| 8. | Pasuritë                | Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me regjistrimin e pasurive për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës, të bëhet azhurnimi i regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, si dhe të shpalosen saktë në PFV. | Gjatë vitit aktual, Komuna kishte korrigjuar gabimin e identifikuar në vitin paraprak lidhur me regjistrimin e pajisjes së teknologjisë informative.                                                                                        | I zbatuar              |
| 9. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.                                                                                                               | Pavarësisht rritjes së llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për mbledhjen e borxheve. Kjo çështje vazhdon të përsëritet ndër vite, edhe përkundër rekomandimeve të dhëna. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Ganimete Dalloshi, Udhëheqëse e ekipit



Valbona Pllana, Anëtare e ekipit



Vjosa Hasanaj, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

### Leter konfirmim


 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA OBILIÇ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC  
 Nr. Br. No: 02-02901-17-673/26  
 Nr. i fq. / Broj / No. pg. \_\_\_\_\_  
 Data / Datum / Date: 22.06.2026  
 OBILIÇ - OBILIČ - OBILIC


 REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E OBILIÇIT  
 OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



#### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:


 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE

|                                          |                 |                                   |                                   |
|------------------------------------------|-----------------|-----------------------------------|-----------------------------------|
| DATA TRANSMITIMIT / DATE OF TRANSMISSION | SHIFRI / NUMBER | NR. PROT. / BR. PROT. / PROT. NO. | NR. PROT. / BR. PROT. / PROT. NO. |
| 04                                       | 47              | 1138                              | 1                                 |

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


 Z. Halil Thaqi  
 Kryetar i Komunës  
 Data: 22.06.2026,

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

## Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

## Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.